



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete teknologjike tip Terminal Truck (4 cope)”, (Procedurë e Hapur mbi kufirin e larte monetar - Mall) - Kontrate

VLERA E FONDIT LIMIT: 82.215.395 (tetëdhjetë e dy milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mije e treqind e nëntëdhjetë e pese) lekë, pa TVSH,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kamionë ngritës pirun, kamionë pune, traktorë platforma hekurudhore 42415000-8

Afati i lëvrimit do jetë **6 (Gjashte) muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se vlera e fondit limit. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku

njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Ofertë Teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për mallrat e listes në formatin e **Ofertes Teknike**, në formën e një tablele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.3 Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve dhe skeden teknike per listen e mjeteve objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë, në rast se është vetë kompania prodhuese, një deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i saj, që vërteton statusin e tij si prodhues i mjeteve objekt prokurimi. Në rast se operatori ekonomik nuk është kompania prodhuese, duhet të paraqesë autorizim të vlefshëm të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për furnizimin e mjeteve objekt prokurimi. Kur autorizimi lëshohet nga një distributor ose

përfaqësues i autorizuar i prodhuesit, operatori ekonomik duhet të paraqesë gjithashtu dokumentacionin që vërteton marrëdhënien juridike ndërmjet prodhuesit dhe distributorit ose përfaqësuesit të autorizuar që ka lëshuar autorizimin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit/distributorit, si numrin e telefonit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe faqen zyrtare të internetit (website), sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor për qëllime verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 6, të nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që është prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

- 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të prodhuesit ose dokumentacion tjetër të lëshuar nga prodhuesi, që konfirmon disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për mjetet e ofertuara për një periudhë minimale prej 10 (dhjetë) vitesh nga data e marrjes se tyre në dorezim.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të mjeteve teknologjike tip Terminal Truck gjatë ciklit të tyre të përdorimit, duke siguruar disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të arsyeshme pas dorëzimit të tyre. Duke qenë se bëhet fjalë për mjete teknologjike portuale të specializuara dhe me vlerë të lartë investimi, mungesa e pjesëve të këmbimit do të ndikonte drejtpërdrejt në vazhdimësinë e operacioneve, kostot e mirëmbajtjes dhe jetëgjatësinë e mjeteve.

Kërkesa është në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcionale me natyrën e furnizimit dhe synon mbrojtjen e interesit publik nëpërmjet garantimit të funksionimit dhe mirëmbajtjes afatgjatë të mjeteve objekt prokurimi.

- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit ku është i regjistruar, ose dokumente ekuivalente, që vërtetojnë ushtrimin e veprimtarisë në fushën e furnizimit dhe shitjes së mjeteve teknologjike portuale, pajisjeve portuale ose mjeteve të ngjashme me objektin e prokurimit.

Për operatorët ekonomikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, kërkohet paraqitja e licencës së vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), sipas kategorisë VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio” në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së

Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016, si dhe me legjislacionin në fuqi për lejet dhe licencat , ose licencë tjetër të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Për operatorët ekonomikë të huaj, kërkohet paraqitja e dokumenteve ekuivalente të lëshuara nga autoritetet kompetente të vendit ku janë të regjistruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 5/a , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, kërkesa mbështetet gjithashtu në legjislacionin në fuqi për lejet dhe licencat, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 1546, datë 29.03.2016 “Për Autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, në pjesën që përcakton kategorinë VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë në mënyrë të ligjshme veprimtarinë në fushën e furnizimit dhe shitjes së mjeteve të rënda industriale, pajisjeve portuale ose mjeteve të ngjashme me objektin e prokurimit. Kërkesa synon të garantojë që operatori ekonomik disponon të drejtën ligjore për ushtrimin e këtij aktiviteti dhe është i autorizuar nga autoritetet kompetente të vendit ku është i regjistruar.

Për operatorët ekonomikë të huaj, kërkohet paraqitja e dokumenteve ekuivalente të lëshuara nga autoritetet kompetente të vendit ku janë të regjistruar, në respektim të parimit të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe njohjes së dokumenteve ekuivalente.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e shërbimeve të garancisë, asistencës teknike, mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve teknologjike tip Terminal Truck gjatë periudhës së garancisë.

Kur shërbimet e garancisë, asistencës teknike, mirëmbajtjes dhe riparimit nuk realizohen drejtpërdrejt nga operatori ekonomik ofertues, ky i fundit duhet të paraqesë kontratë bashkëpunimi, marrëveshje ose autorizim të vlefshëm me prodhuesin, distributorin e autorizuar ose me një subjekt teknik të specializuar në mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve teknologjike portuale , pajisjeve portuale ose mjeteve të ngjashme, i cili do të realizojë këto shërbime gjatë periudhës së garancisë.

Subjekti që do të realizojë shërbimet e garancisë, asistencës teknike, mirëmbajtjes dhe riparimit duhet të disponojë:

- **Të paktën një (1) inxhinier** për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, diagnostikimit dhe riparimit të mjeteve Terminal Truck (Terminal Tractor) gjatë periudhës së garancisë, të punësuar pranë subjektit ose të angazhuar nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit. Punësimi ose angazhimi i tij duhet të vërtetohet me listëpagesat e 3 (tre) muajve të fundit ose me kontratë bashkëpunimi të vlefshme. Kualifikimi profesional duhet të vërtetohet me diplome dhe certifikatë trajnimi, dëshmi aftësie profesionale ose dokumente të tjera ekuivalente që lidhen me mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe riparimin e mjeteve të ngjashme.

- Të paktën një (1) mekanik, një (1) specialist për sistemet elektrike dhe elektronike dhe një (1) specialist për sistemet hidraulike, të punësuar pranë subjektit, të vërtetuar me listëpagesat e 3 (tre) muajve të fundit.

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- Të paktën një (1) automjet shërbimi (oficinë lëvizëse), në pronësi ose në përdorim të ligjshëm, për realizimin e ndërhyrjeve teknike në terren gjatë periudhës së garancisë, të vërtetuar me lejen e qarkullimit, targën dhe fotografi të automjetit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 5/b, pika 5/c, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik fitues disponon kapacitetet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga garancia kontraktore, duke siguruar ofrimin në kohë të shërbimeve të asistencës teknike, mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve teknologjike tip Terminal Truck. Kërkesa për paraqitjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ose autorizimit, kur këto shërbime realizohen nga një subjekt tjetër, garanton ekzistencën e një marrëdhënieje juridike të vlefshme ndërmjet operatorit ekonomik dhe subjektit që do të ofrojë shërbimin.

Kërkesa për disponimin e personelit teknik me kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, diagnostikimit dhe riparimit të mjeteve Terminal Truck (Terminal Tractor), si dhe për disponimin e personelit të specializuar për sistemet mekanike, elektrike, elektronike dhe hidraulike, është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit. Duke qenë se këto mjete do të përdoren në operacione portuale intensive dhe duhet të garantojnë vazhdimësinë e aktivitetit, Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të sigurojë kapacitete teknike të mjaftueshme për ndërhyrje, diagnostikim dhe riparim gjatë gjithë periudhës së garancisë.

Kërkesa për disponimin e një automjeti shërbimi (oficinë lëvizëse), në pronësi ose në përdorim të ligjshëm, synon të garantojë mundësinë e realizimit të ndërhyrjeve teknike në terren, duke

reduktuar kohën e qëndrimit jashtë funksionit të pajisjeve dhe duke siguruar reagim të shpejtë në rast defektesh ose nevojë për asistencë teknike.

Këto kërkesa janë proporcionale me objektin e prokurimit, karakteristikat e mjeteve të kërkuara dhe kushtet e operimit në terminal portual, dhe nuk kufizojnë konkurrencën, pasi kapacitetet teknike mund të disponohen si drejtpërdrejt nga operatori ekonomik, ashtu edhe nëpërmjet subjekteve të angazhuara prej tij sipas legjislacionit në fuqi.

- 2.3.8** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mjetet teknologjike tip Terminal Truck të ofruara janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian për sigurinë e mjeteve dhe pajisjeve dhe se, në momentin e dorëzimit, do të pajisen me Deklaratën e Konformitetit CE ose dokument ekuivalent të lëshuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79, pika 1, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar që mjetet teknologjike tip Terminal Truck të ofruara janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian për sigurinë e mjeteve dhe pajisjeve dhe plotësojnë standardet e aplikueshme të sigurisë, cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesa për deklarimin nga operatori ekonomik dhe paraqitjen, në momentin e dorëzimit, të Deklaratës së Konformitetit CE ose dokumentit ekuivalent të lëshuar nga prodhuesi, garanton se mjetet e furnizuara janë objekt i procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e sigurisë të përcaktuara nga legjislacioni përkatës. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën e furnizimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi lejon edhe paraqitjen e dokumenteve ekuivalente.

- 2.3.9** Kompania prodhuese duhet të paraqesë certifikaten përkatëse të vlefshme të sistemit të menaxhimit, të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar ose dokumente ekuivalente, si më poshtë:

➤ **ISO 9001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është vendosur me qëllim garantimin që kompania prodhuese e mjeteve teknologjike tip Terminal Truck zbaton një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë gjatë projektimit, prodhimit dhe kontrollit të produktit. Certifikimi sipas standardit ISO 9001:2015, ose dokumenti ekuivalent, garanton se proceset e prodhimit zhvillohen në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtarisht të menaxhimit të cilësisë, duke rritur besueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë e mjeteve objekt prokurimi. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale me natyrën dhe vlerën e furnizimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohet edhe dokumentacion ekuivalent.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është kompania prodhuese por distributor ose përfaqësues i autorizuar i saj, duhet të paraqesë certifikata të vlefshme të sistemeve të menaxhimit, të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar ose dokumente ekuivalente, të lidhura me aktivitetin e furnizimit dhe mbështetjes teknike të pajisjeve objekt prokurimi, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent**
- **ISO 14001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit Mjedisor” (e vlefshme) ose ekuivalent**
- **ISO 45001:2018 – “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur me qëllim që operatori ekonomik ofertues, kur nuk është kompania prodhuese, të dëshmojë se disponon sisteme të certifikuara të menaxhimit për realizimin e aktivitetit të furnizimit, mbështetjes teknike dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Certifikimi sipas standardeve ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, ose dokumenteve ekuivalente, garanton se operatori ekonomik zbaton procedura të standardizuara për menaxhimin e cilësisë, mbrojtjen e mjedisit, si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë, duke rritur besueshmërinë në realizimin e kontratës dhe në ofrimin e shërbimeve të garancisë dhe mbështetjes teknike. Këto certifikata lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, janë proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizojnë konkurrencën, pasi pranohen edhe dokumente ekuivalente të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar.

Argumentimi i mosndarjes se procedurës ne lote:

1. Referuar nenit 39 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktor vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, pasi natyra e furnizimeve objekt i kësaj procedure **(Blerje mjete teknologjike tip Terminal Truck (4 cope)** kërkon uniformitet teknik, përputhshmëri të plotë ndërmjet komponentëve të pajisjes dhe garantimin e integritetit funksional të mjetit të furnizuar.

Terminal Truck (Terminal Tractor) është një mjet teknologjik kompleks, i cili përbëhet nga sisteme të ndërlidhura mekanike, hidraulike, elektrike, elektronike dhe të kontrollit, të cilat janë të projektuara dhe integruara nga prodhuesi si një njësi e vetme operationale. Për këtë arsye, furnizimi i elementëve dhe komponentëve të tij duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike, standardet e prodhuesit dhe kërkesat e performancës së mjeteve.

Ndarja e procedurës në lote do të mund të krijonte risk për furnizimin e komponentëve ose elementëve teknikë nga operatorë ekonomikë të ndryshëm, duke sjellë vështirësi në garantimin e kompatibilitetit teknik, integritetit të sistemeve dhe përgjegjësisë së plotë për funksionimin e mjeteve. Çdo mospërputhje teknike ndërmjet sistemeve të furnizuara mund të ndikojë në performancën e mjeteve Terminal Truck, sigurinë operationale, besueshmërinë në punë dhe kostot e mirëmbajtjes gjatë ciklit të jetës së mjetit.

Gjithashtu, duke qenë se mjetet Terminal Truck (Terminal Tractor) do të përdoren për operacionet e transportit të brendshëm të rimorkiove dhe kontejnerëve në Terminalin e Konteniereve të Autoritetit Portual Durrës, në kushte pune intensive dhe me ngarkesa të rënda, kërkohet që mjeti i furnizuar të jetë një sistem teknik i unifikuar, i projektuar, testuar dhe certifikuar nga prodhuesi, duke garantuar përgjegjësi të qartë për cilësinë, performancën, garancinë dhe shërbimin pas shitjes.

Për më tepër, zhvillimi i procedurës pa ndarje në lote garanton një përgjegjësi të unifikuar kontraktuale për furnizimin, instalimin, vënien në punë, garancinë dhe mbështetjen teknike të mjeteve, si dhe shmang problematikat administrative dhe operacionale që mund të lindnin nga menaxhimi i disa kontratave të ndara për një mjet të vetëm teknologjik me sisteme të integruara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Garancia e mallrave të ofruara:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mjetet teknologjike tip **Terminal Truck** objekt i kësaj procedure, për një periudhë jo më pak se **24 (Njezet e kater) muaj** ose **4000 (Katër mijë)** orë pune, cilado të plotësohet e para, nga data e marrjes në dorëzim të mjetit nga Autoriteti Kontraktor.

Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik është përgjegjës për funksionimin normal të mjeteve dhe detyrohet të kryejë pa kosto për Autoritetin Kontraktor riparimin, zëvendësimin e pjesëve ose komponentëve me defekt, si dhe korrigjimin e çdo anomalie teknike që lidhet me prodhimin, montimin ose furnizimin e mjeteve.

Ndërhyrjet e nevojshme gjatë periudhës së garancisë duhet të kryhen brenda një afati të arsyeshëm nga marrja e njoftimit nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar rikthimin e mjeteve në gjendje pune dhe minimizimin e ndërprerjeve të aktivitetit operacional.

Garancia duhet të mbulojë të gjitha sistemet dhe komponentët kryesorë të mjeteve Terminal Truck, përfshirë sistemin mekanik, hidraulik, elektrik, elektronik dhe sistemet e kontrollit, sipas specifikimeve të prodhuesit.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mjetet teknologjike tip Terminal Truck objekt i kësaj procedure janë të reja dhe të papërdorura më parë.

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

A. Në fazen e pranim, janë të detyruar të paraqesin;

- 1. Dokumente origjinale ose të njezlefshme, të deklaruara në institucionet tona zyrtare, me ane të cilave të demonstron produktet e ofruara**
- 2. Dokumenta që vërtetojnë Origjinën e Produkteve të furnizuara, si Certifikatë Origjine ose dokument ekuivalent**

3. **Manualin origjinal të përdorimit dhe mirëmbajtjes** së mjeteve Terminal Truck
4. **Katalogun e pjesëve të këmbimit** dhe dokumentacionin teknik të mirëmbajtjes
5. **Dokumentacionin që vërteton kryerjen e kontrolleve dhe testeve funksionale të pajisjes para dorëzimit, të realizuara nga prodhuesi sipas procedurave të kontrollit të cilësisë së tij (Factory Acceptance Test ose dokument ekuivalent)**
6. **Deklaratën e Konformitetit CE** ose dokument ekuivalent të lëshuar nga prodhuesi, që vërteton se mjetet Terminal Truck të furnizuar janë në përputhje me standardet e sigurisë, cilësisë dhe kërkesat teknike të aplikueshme.
7. **Dokumentacionin e garancisë së prodhuesit dhe kushtet e garancisë**, të vlefshme për mjetet e furnizuara.
8. **Realizimi i trajnimit të personelit të Autoritetit Kontraktor** për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve Terminal Truck, nga personel i kualifikuar dhe i autorizuar nga prodhuesi.
9. **Në fazën e marrjes në dorëzim të mjeteve**, Autoriteti Kontraktor do të kryejë verifikimin fizik të mjeteve Terminal Truck të furnizuar, duke përfshirë kontrollin e numrit serial, markës, modelit, konfigurimit, parametrave teknikë dhe përputhshmërisë së tij me ofertën teknike të paraqitur. Gjithashtu do të kryhen prova funksionale të mjeteve në prani të përfaqësuesve të operatorit ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor, me qëllim verifikimin e funksionimit normal të tyre.

AUTORITETI KONTRATOR rezervon të drejtën të refuzojë mallrat që nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara dhe parametrat e deklaruar në dokumentacionin teknik.

VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA

AUTORITETI KONTRATOR, rezervon të drejtën të kryejë, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, për të garantuar mbi vlefshmerinë e dokumenteve të kërkuara.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat reale të Autoritetit Kontraktor për mjetet teknologjike objekt të kësaj procedure prokurimi, duke analizuar kërkesat operative të aktivitetit portual, nevojat për transportin e brendshëm të kontejnerëve dhe rimorkiove në Terminalin e Kontenierëve të Autoritetit Portual Durrës, si dhe karakteristikat teknike të mjeteve të kërkuara tip **Terminal Truck (Terminal Tractor)**.*

Për hartimin e specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme për mjetet e transportit industrial dhe pajisjet e përdorura në operacione portuale, me qëllim garantimin e sigurisë operative, performancës, qëndrueshmërisë, besueshmërisë dhe jetëgjatësisë së mjeteve të furnizuara.

Specifikimet teknike përfshijnë kërkesa të përcaktuara lidhur me kapacitetin tërheqës të mjetit, konfigurimin e Terminal Truck-ut, karakteristikat e shasisë, sistemet e frenimit dhe drejtimit, motorin, transmisionin, sistemet elektrike dhe elektronike, sistemet e sigurisë, pajisjet ndihmëse dhe parametrat e tjerë teknikë të nevojshëm për realizimin e transportit të brendshëm të kontejnerëve dhe operacioneve të vazhdueshme në terminal.

Përcaktimi i këtyre karakteristikave teknike është bërë me qëllim sigurimin e furnizimit me mjete teknologjike të përshtatshme për kushtet e operimit në mjedis portual, ku kërkohet përdorim intensiv, cikle të përsëritura pune dhe transport i ngarkesave të rënda. Kërkesat synojnë garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të mjeteve, sigurisë së personelit dhe optimizimin e kostove të mirëmbajtjes gjatë gjithë ciklit të jetës së pajisjeve.

Kërkesat teknike janë hartuar duke u bazuar në nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor dhe jo në referenca që favorizojnë një prodhues të caktuar, duke lejuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që ofrojnë mjete ekuivalente ose me karakteristika teknike të njëjta ose më të larta.

Ky përcaktim është në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit për Prokurimin Publik, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, duke respektuar parimet e mosdiskriminimit, konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE **PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT**